



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 407/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha, kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës Branimir Stojanoviq nga subjekti politik G.I Srpska Lista, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen si te bazuara ankesat Anr. 407/2017 dhe Anr. 420/2017 të datës 30.06.2017, te Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Branimir Stojanoviq nga subjekti politik G.I Srpska Lista.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për të gjitha subjektet politike dhe të gjithë kandidatëve të tyre në Vendvotimet: 2303d/01R, 2303d/02R, 2303d/03R, 2303d/04R, 2304d/01R, 2304d/02D, 2306d/02R, 2308d/02R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive te votimeve në Vendvotimet si në pikën-II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

Branimir Stojanoviq nga subjekti politik G.I Srpska Lista me datën 30.06.2017 ka paraqitur në PZAP, ankesat me numër Anr. 407/2017, dhe Anr 420/2017

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, i ka bashkuar ankesat Anr. 407/2017, dhe Anr 420/2017 të datës 30.06.2017, dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me Anr. 407/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Nga ankesat e paraqitura nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Branimir Stojanoviq nga subjekti politik G.I Srpska Lista, pretendohet se gjatë rinumërimit të

materialit zgjedhor nga vendvotimi 2303d/03R në komunën e Shtërpcës, janë vërtetuar shumë parregullsi. Parashtruesi i ankesës thekson se këto shkelje i ka kuptuar me datë 29.06.2017 në ora 14:00 nga momenti i publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja. Po ashtu ai thekson se ka pas parregullsi të karakterit të njëjtë edhe në vendvotimet në vijim ku është parë qartazi se procesverbalet origjinale nga vendvotimet e theksuar nuk përmbajnë gjendje e saktë faktike në kutitë të votimit:

1. 2303d/01R në komunën e Shtërpcës
2. 2303d/02R në komunën e Shtërpcës
3. 2303d/04R në komunën e Shtërpcës
4. 2304d/01R në komunën e Shtërpcës
5. 2304d/02D në komunën e Shtërpcës
6. 2306d/02R në komunën e Shtërpcës
7. 2308d/02R në komunën e Shtërpcës

Sipas pretendimeve në ankesë në nivelin e komunës së Shtërpcës është raportuar votimi me asistencë në më shumë se 1000 raste, gjë e cila tregon se kjo është përqindja më e lartë e kësaj lloji të votimit në gjithë procesin zgjedhor. Nëse merret parasysh se në nivel të Komunës së Shtërpcës dalja përgjithshme është diku rreth 6000 qytetarë, atëherë del se diku 20% të votave janë votat nga votimi me asistencë.

Parashtruesi i ankesës më tutje thekson se të gjitha pretendimet e theksuara mund të vërtetohen me qasje në kutinë e votimit me nr. 2303d/03R, duke e shikuar listën e votuesve me nënshkrimet e votuesve, ku sjelljet e tilla janë padyshim shkelje e rëndë e shumë neneve të LZP-së dhe Kodit Penal të Kosovës. Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që kjo ankesë të pranohet si e bazuar dhe ti vërtetohet shkeljet e pretenduara.

Si prova është bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularët e Përputhjes së të dhënave për vendvotimet e lartcekura, si dhe të dhënat e publikuara nga KQZ-ja.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuese, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për të gjitha subjektet politike dhe të gjithë kandidatët e tyre për vendvotimet 2303d/01R,

2303d/02R, 2303d/03R, 2303d/04R, 2304d/01R, 2304d/02D, 2306d/02R, 2308d/02R, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 407/2017 më datën 02.07.2017.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.